

ABSTRAKT

Adoptimi vendor dhe ndërkombëtar në Kosovë, procedura gjyqësore dhe roli i organit të kujdestarisë

Në këtë punim trajtohet dhe analizohet instituti i adoptimit në përgjithësi, që nga e drejta romake e deri më sot. Adoptimi është një nga format themelore të mbrojtjes juridiko-familjare të fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe me përkujdesje joadekuate prindërore. Ky institucion juridik është i rregulluar me Ligjin për Familjen si dhe me Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare. Por kur bëhet fjalë për adoptimin, këtë çështje përveç dispozitave ligjore të vendit tonë, e rregullojnë edhe konventat ndërkombëtare të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë merren me trajtimin e këtij institucioni juridiko-familjar. Procedura e adoptimit është në kompetencë të gjykatës, dhe gjykata mund të kërkojë këshilla nga organi i kujdestarisë gjatë marrjes së vendimit. Organi i kujdestarisë do të caktojë vetëm personel të trajnuar i cili do të jetë i përshtatshëm për detyrën, kjo për shkak të veçorive personale, si dhe i cili do të ketë përvojë profesionale të punës me fëmijët.

Në Republikën e Kosovës lejohet adoptimi i fëmijëve që kanë shtetësi të Kosovës dhe adoptimi i fëmijëve kosovarë nga shtetasit e huaj. Legjislacioni ynë rregullon adoptimin vendor dhe ndërkombëtar, andaj tema në fjalë do të trajtojë natyrshëm procedurën gjyqësore për adoptim në të dy rastet e lartcekura, si dhe procedurat administrative të cilat kryhen përmes Qendrave për Punë Sociale dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, pasi që është detyrë e këtyre autoriteteve që të verifikojnë se a janë plotësuar apo jo të gjitha kushtet e domosdoshme për adoptim.

Për realizimin e qëllimit të tij, punimi është mbështetur kryesisht në këto metoda: metoda e analizës, krahasuese, sistematike, dhe normative.

Në përfundim të këtij punimi vlen të theksohet se me themelimin e adoptimit, në mes të palës adoptuese dhe të adoptuarit lindin të njëjtat të drejta dhe detyrime që ekzistojnë në mes të prindërve dhe fëmijëve, fëmija i adoptuar e fiton statusin ligjor të fëmijës së prindërve adoptues, dhe me themelimin e adoptimit transferohet e drejta prindërore nga prindërit biologjikë të fëmijës tek prindërit adoptues të fëmijës.

Fjalët kyçe: adoptim, procedurë, dispozita ligjore, fëmijë, etj.

ABSTRACT

International and vendor adaptation in Kosovo, court procedures and the role of the care department.

In this seminar the institution of adaptation is treated and analyzed in general, from the Romans right up today. Adaptation is one of the basic forms of legal-family protection of children without parental care and inadequate parental care. This legal institution is regulated by Law for Family as well as with the Low for Family Social Services. But when it comes to adaptation, this issue except law dispositions of our country, regulate the international conventions too which directly or indirectly deal with treatment of this institution of legal-family. The procedure of adaptation is within the jurisdiction of the court and that the court can require advice from the care department upon taking any decisions. The care department will appoint trained personnel only which will be adequate for the duty, this due to personal characteristics, whom will have professional work experience with the children.

Adaptation of the children is allowed in the Republic of Kosovo who have Kosovo citizenship and adaptation of the Kosovan children from the foreign citizens. Our legislation regulates the vendor and international adaption, therefore the theme will treat naturally the court procedure for adaption in the two mentioned cases above, as well as administrative procedure which are completed through Centers for Social Work and Ministry of Work and Social Welfare, as it is the responsibility of these authorities to verify whether requirements for adaption have been met.

In order to realize its goal, the seminar was supported mainly in these methods: method of analysis, comparing, systematic and normative.

In concluding this seminar, it is worth mentioning that when establishment of adaptation occurs, between adopting party and the adopted, the same rights and duties appear which exist between parents and children, the adopted child gains the status of legal child of the adopted parents and with the establishment of the adaptation, the parental right is transferred from the biological parents to the adopted parents of the child.

Key words: adaptation, procedure, law dispositions, children, etc.